



Prishtinë: 19.05.2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_814\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1446\_03\_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **06.04.2016**

### në seancën e mbajtur më datë 19 maj 2016, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A.P. me shifër DPR – 40659 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1446\_03\_16** i datës 22.03.2016.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 06.04.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori A.P. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: Konsumatori ka kërkuar që vendimi i atakuar të rishikohet edhe njëherë, e këtë e bazon në faktin se për mos matjen e shpenzimeve të energjisë elektrike të konstatuara nga laboratorit i kalibrimit sipas konsumatorit nuk janë përgjegjësi e konsumatorit për ndërrimin e njehsorit dhe vlerës së llogaritur. Pika tjetër e kundërshtimit është se organi shkallës së parë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale në dëm të konsumatorit. Gjithashtu i njëjti thekson se faturimi në këtë mënyrë është i paligjshëm pasi që i njëjti nuk ka bërë kurrfarë keqpërdorimi. Konsumatori thekson se edhe po të ishte krijuar ky borxh i njëjti është parashkruar në bazë të dispozitave të ligjit mbi detyrimet, pasi që siç përcaktohet me këtë ligj afati i parashkrimit është 1 vjeçar andaj një kërkesë e tillë konsiderohet se është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 06.11.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku gjatë inspektimit kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 279863 me gjendje T=17441 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 63849525 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU= 000000 kWh.

Gjithashtu Departamenti i faturimit në KEDS me datë 02.12.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën 1114176203DPR-69400 të datës 02.12.2014 me shpenzim prej **4,052 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **441.76€**. Me datë 25.11.2014 Departamenti i faturimit në KEDS përmes urdhër



lejimit/korrigjimit nr.69727DPR-69400 ka bërë korrigjimin e faturave për periudhën 05/2014 - 10/2014 përfshirë edhe faturën kontestuese nr. 1114176203DPR-69400 të datës 02.12.2014.

I pakënaqur me faturën e dërguar nga ana e KESCO-së, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke kundërshtuar faturën nr.1114176203DPR-69400 e datës 02.12.2014 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë. Lidhur me këtë Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 27.01.2015 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe procesverbalit të kalibrimit nr.34 të datës 14.01.2015, duke bërë korrigjimin plotësues prej **+171.25€** përmes urdhër lejimit/korrigjimit nr.71573DPR-69400.

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-së, konsumatori me datë 10.05.2015 i është drejtuar DMK/ZRRE me ankesë me të cilën ka apeluar përgjigjen e KESCO-së dhe ka kërkuar që ti shlyhet borxhi i ngarkuar sipas tij në mënyrë paushallë, si dhe ngarkesën shtesë të faturuar nga KESCO. DMK/ZRRE, pas shqyrtimit e ankesës së konsumatorit me datë 22.03.2016 ka marr vendim me të cilën ka refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga ana e konsumatorit A.P. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë me të drejt ka vërtetuar faktin se njehsori elektrik i konsumatorit ka qenë i dëmtuar teknikisht. Ky konstatim është bazuar nga procesverbali i qendrës së kalibrimit i datës 14.01.2015 ku kanë konstatuar se njehsori elektrik nga ana e jashtme përfshirë edhe vulat shtetërore janë në rregull, kurse në brendi të njehsorit sistemi i fazës së tretë "T" është i djegur dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike për **33%** më pak. Sipas të dhënave të evidentuara në procesverbal gjendja e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr. 279863 me rastin e shqyrtimit është **TL=17441** kWh, e që kjo gjendje përputhet edhe me shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr. 0110728 të datës 06.11.2014.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të procesverbalit të kalibrimit dhe konstatimeve të bëra nga ky laborator, ashtu siç u theksua edhe më lartë ka konstatuar se korrigjimi i bërë nga ana e KESCO-së e i vërtetuar edhe nga ana e Departamentit për Konsumator në ZRRE është i drejt dhe i bazuar në rregulla dhe ligje. Për me tepër dispozita ligjore e nenit 4.11.1 të Kodit të matjes e përcakton rastet kur paraqiten defektet teknike në njehsorin elektrik (pasaktësia në matje) dhe me këtë rast lejohet të bëhet korrigjimi i vlerës së humbur si pasojë e gjendjes së njehsorit elektrik qoftë në rast se është dëmtuar konsumatori apo ndërmarrja e energjisë.

Bordi ka analizuar edhe korrigjimin e bërë nga ana e KESCO-së, korrigjimet me nr. 69727DPR-69400 të datës 25.11.2014 dhe nr. 71573DPR-69400 të datës 27.01.2015 dhe ka konstatuar se KEDS/KESCO ka vepruar drejt dhe në përputhje me nenin 23 paragrafin 3 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji ku thuhet se: *"Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese"*.

Bordi ka analizuar edhe pikën e kundërshtimit të theksuar në ankesë nga ana e konsumatorit i cili është thirrur në parashkrim të borxhit për shkak se ndërmarrja e energjisë borxhin e humbur nuk e ka kërkuar dhe si rezultat i kësaj ka ardhur edhe te parashkrimi 1 vjeçar. Lidhur me këtë pikë të kundërshtimit Bordi ka konstatuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit pasi që i njëjti borxh për atë periudhë nuk ka mundur të faturohet si pasojë e defekteve teknike të shkaktuara në njehsorin elektrik për raste të tilla (defekte teknike) janë paraparë edhe dispozita



ligjore për mundësin e korigjimit (+/-), ashtu siç u theksuan edhe më lartë me këtë vendim, andaj në këtë situatë nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit, por kemi të bëjmë me obligim ligjor që të paguhet energjia e shpenzuar nga ana e konsumatorit.

Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në menyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për këtë pikë matëse dhe është vërtetuar se KESCO ka aplikuar drejt dispozitat e nenit 23 paragrafi 1 dhe 2 të Rregulles për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Krenar Bujupi, anëtar

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit A.P.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.